Akti i Themelimit i/
Act of Incorporation of

# "Aga Solar I RF"

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar/
Limited liability company

FSS

<table>
<tr><td>AKTI I THMELIMIT I<br><br>SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR</td><td>ACT OF INCORPORATION OF<br><br>THE LIMITED LIABILITY COMPANY</td></tr>
<tr><td colspan="2">"Aga Solar I RF" SHPK</td></tr>
</table>

Sot, në Tiranë, më 13/12/2024, Ortakët e shoqërisë "Aga Solar I RF" SHPK:

- **Aga Solar Holdco Limited,** a British company duly registered with the Companies House under registration no. 16107480, with its address at 2nd Floor 1 Earlham Street, London, England, WC2H 9LL (**"Aga Solar Holdco"**).;

- **NOTUS Energy Albania SH.P.K.,** një shoqëri shqiptare e regjistruar rregullisht pranë Qendrës Kombëtare Shqiptare të Biznesit (Regjistri Tregtar) më 22 shtator 2023, nën nr. Unik identifikues të subjektit (NUIS) M32122022B, me adresë në Rruga e "Elbasanit", Pallati Edil- AL, Kati 2, Zyra 216, Tiranë, përfaqësuar rregullisht nga administratori Z. Rico Koch (**"Notus Energy Albania"**);

- **AGA-SOLAR SH.P.K.,** një shoqëri shqiptare e regjistruar rregullisht pranë Qendrës Kombëtare Shqiptare të Biznesit (Regjistri Tregtar) më 15 shkurt 2021, nën nr. unik identifikues të subjektit (NUIS) M11415029E, me adresë në Bashkinë Kashar - Tiranë, Zona Kadastrale 2679, Numri i Pasurisë 34/13/1, Pallati ARDENO, km 2, MEZEZ, Tiranë, Shqipëri (**"Aga Solar"**);

(këtu e më tej referuar si **"Ortakët"**),

miratuan këtë Akt Themelimi si më poshtë:

Today, in Tirana, on 13/12/2024, the Partners of the company "Aga Solar I RF" SHPK:

- **Aga Solar Holdco Limited,** një shoqëri britanike e regjistruar rregulisht pranë Shtëpisë së Kompanive me nr. regjistrimi 16107480, me adresë në Katin e 2-të 1 Earlham Street, Londër, Angli, WC2H 9LL (**"Aga Solar Holdco"**).;

- **NOTUS Energy Albania SH.P.K.,** an Albanian entity duly registered with the Albanian National Business Centre (Commercial Registry) on 22 September 2023, under tax unique reg. no. (NUIS) M32122022B, with its address at Street "Elbasanit", Building Edil-AL, Floor 2, Office 216, Tirana, duly represented by the administrator, Mr. Rico Koch (**"Notus Energy Albania"**);

- **AGA-SOLAR SH.P.K.,** an Albanian entity duly registered with the Albanian National Business Centre (Commercial Registry) on 15 February 2021, under tax unique reg. no. (NUIS) M11415029E, with its address at Kashar Municipality - Tirana, Cadastral Zone 2679, Property number 34/13/1, ARDENO Building, km 2, MEZEZ, Tirana, Albania (**"Aga Solar"**);

(hereinafter referred to as the **"Partners"**),

approved the present Act of Incorporation as follows:

## THEMELIMI

### Neni 1

1.1 Ortakët miratojnë themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **"Aga Solar I RF"** SHPK (këtu e më tej referuar si **"Shoqëria"**), në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në

## INCORPORATION

### Article 1

1.1 The Partners approve the incorporation of the limited liability company **"Aga Solar I RF"** SHPK (hereinafter referred to as the **"Company"**), in accordance with the

FSS
Rd

veçanti me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*, i përditësuar (këtu e më tej **"Ligji për Shoqëritë Tregtare"**).

1.2 Selia e Shoqërisë është në adresën: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Qendra Tregtare, Kati 2, Nr. 24, 1019, Tiranë, Shqipëri.

1.3 Shoqëria themelohet për një kohëzgjatje të pakufizuar.

**OBJEKTI**

**Neni 2**

2.1 Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj si një subjekt me qëllim të veçantë në fushën e energjisë së rinovueshme dhe objekti i saj përfshin, por nuk kufizohet në:

(a) Kryerjen e çfarëdo veprimtarie që është nevojshme dhe e përshtatshme për të realizuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja për Zhvillimin e Projektit lidhur mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë dhe bashkimit të shoqërive të përberë nga SCF Master Holdco Limited, Notus Energy GmbH dhe Aga-Solar Sh.p.k, përfshire, por pa u kufizuar në: projektimin, ndërtimin, instalimin, kolaudimin, financimin, operimin, përmirësimin, dhe mirëmbajtjen e centralit të prodhimit të energjisë nga dielli dhe infrastrukturës mbështetëse, përfshirë panelet fotovoltaike të ndodhura në territorin e Bashkisë Fier, Shqipëri (**"Impjanti"**) si dhe linjën e transmetimit të energjisë elektrike që do të lidhë Impjantin me rrjetin shqiptar të energjisë;

(b) Prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike të prodhuar nga Impjanti.

(c) Zotërimin e të drejtave të kalimit që do ta lejojnë lidhjen e Impjantit me rrjetin shqiptar të energjisë elektrike me anë të linjës së transmetimit.

(d) Për arritjen e qëllimit të mësipërm, Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, dhe çdo

legislation in force and in particular with Law No. 9901 dated 14.04.2008 *"On entrepreneurs and commercial companies"*, as amended (hereinafter referred to as the **"Company Law"**).

1.2 The headquarters of the Company is at the address: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Twin Towers, Commercial Center, 2nd floor, No. 24, 1019, Tirana, Albania.

1.3 The Company is established for an unlimited duration.

**SCOPE**

**Article 2**

2.1 The Company exercises its activity as a special purpose vehicle in the field of renewable energy and its object includes but is not limited to:

(a) Performing any activity that is necessary and appropriate to fulfill the rights and obligations arising from the Project Development Agreement entered into by the Ministry of Infrastructure and Energy of the Republic of Albania and the consortium of companies composed of SCF Master Holdco Limited, Notus Energy GmbH and Aga-Solar Sh.p.k, including but not limited to: design, construction, installation, commissioning, financing, operation, improvement, and maintenance of the solar power plant and supporting infrastructure, including the photovoltaic panels located in the territory of the Municipality of Fier, Albania (the **"Facility"**) as well as the electricity transmission line that will connect the Facility to the Albanian energy network;

(b) Production and sale of electricity produced by the Facility.

(c) Possession of the rights of passage that will allow the connection of the Facility with the Albanian electricity network through the transmission line.

(d) To achieve the above purpose, the Company may carry out any transaction related to movable and immovable assets, and any other

FSS

RU

| | |
|---|---|
| aktivitet tjetër tregtar, financiar, qiraje ose hipoteke, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i Shoqërisë. | commercial, financial, rental or mortgage activity, which may be considered valid or necessary in order to exercise the object of the Company. |
| 2.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Marrëveshjen për Zhvillimin e Projektit, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër që lidhet direkt ose indirekt me objektin e saj në Republikën e Shqipërisë. | 2.2 In accordance with the legislation in force and the Project Development Agreement, the Company may carry out any activity in the Republic of Albania related to its object. |
| **STATUTI** | **ARTICLES OF ASSOCIATION** |
| **Neni 3** | **Article 3** |
| Ortakët deklarojnë miratimin e Statutit të Shoqërisë. | The Partners declare the approval of the Articles of Association of the Company. |
| **KAPITALI** | **SHARE CAPITAL** |
| **Neni 4** | **Article 4** |
| 4.1 Kapitali i regjistruar dhe tërësisht i paguar i Shoqërisë është 100 ALL (njëqind lekë), i ndarë në 3 (tre) kuota, në pronësi të ortakëve të Shoqërisë, si më poshtë vijon: | 4.1 The registered and fully paid capital of the Company is 100 ALL (one hundred lek), divided into 3 (three) shares, owned by the partners of the Company, as follows: |
| - **Aga Solar Holdco** , zotëruese e 1 (një) kuote, me vlerë nominale 65 ALL (gjashtëdhjetë e pesë lekë) e cila përfaqëson 65 (gjashtëdhjetë e pesë) % të kapitalit të Shoqërisë. | - **Aga Solar Holdco**, owner of 1 (one) share, with a nominal value of 65 ALL (sixty-five lek), which represents 65 (sixty-five) % of the Company's capital. |
| - **NOTUS Energy Albania**, , zotëruese e 1 (një) kuote, me vlerë nominale 20 ALL (njëzetë lekë) e cila përfaqëson 20 (njëzetë) % të kapitalit të Shoqërisë. | - **NOTUS Energy Albania**, owner of 1 (one) share, with a nominal value of 20 ALL (twenty lek), which represents 20 (twenty) % of the Company's capital. |
| - **Aga Solar**, zotëruese e 1 (një) kuote, me vlerë nominale 15 ALL (pesëmbëdhjetë lekë) e cila përfaqëson 15 (pesëmbëdhjetë) % të kapitalit të Shoqërisë. | - **Aga Solar**, owner of 1 (one) share, with a nominal value of 15 ALL (fifteen lek), which represents 15 (fifteen) % of the Company's capital. |
| 4.2 Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e Shoqërisë dhe mbulojnë humbjet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. | 4.2 The Partners are not responsible for the obligations of the Company and cover the losses of the Company up to the outstanding part of the subscribed contributions. |
| **ORGANET E SHOQËRISË** | **BODIES OF THE COMPANY** |

FSS

ZU

**Neni 5**

5.1 Organet e Shoqërisë janë si më poshtë:

(a) Asambleja e Përgjithshme;

(b) Administratori.

**Neni 6**

6.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

6.2 Të drejtat e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortakët.

6.3 Asambleja e Përgjithshme ushtron kompetencat e saj për të miratuar vendime në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

**Neni 7**

7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.

7.2 Administratori i parë i Shoqërisë për një mandat fillestar 1 (një) vjeçar është:

- Znj. Ana Goro

7.3 Me mbarimin e mandatit të administratorit të emëruar sipas pikes 7.2 më sipër, administratorët do të emërohen nga Asambleja e Përgjithshme për një mandat prej 5 (pesë) vitesh, me të drejtë rizgjedhjeje.

7.4 Administratori është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë dhe përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët.

7.5 Administratori është përgjegjës për aktivitetin e zakonshëm tregtar të Shoqërisë dhe ushtron kompetencat e tij në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

7.6 Në rast se Shoqëria emëron më shumë se një administrator, Shoqëria mund të përfaqësohet nga secili prej tyre individualisht, përmes një nënshkrimi të vetëm. Megjithatë, Shoqëria mund të vendosë rregulla të tjera përfaqësimi për administratorët, të cilat miratohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, të cilat do t'u njoftohen administratorëve dhe do të regjistrohen në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**Article 5**

5.1 The bodies of the Company are as follows:

(a) the General Assembly;

(b) the Administrator.

**Article 6**

6.1 The General Assembly is the supreme decision-making body of the Company.

6.2 The rights of the General Assembly are exercised by the Partners.

6.3 The General Assembly exercises its powers to adopt resolutions in accordance with the Articles of Association of the Company and the Company Law.

**Article 7**

7.1 The Company is managed by one or more administrators, who are appointed by the General Assembly.

7.2 The first administrator of the Company for an initial 1 (one) year term is:

- Mrs. Ana Goro

7.3 Upon the expiration of the term of administrator appointed pursuant to paragraph 7.2 above, the administrators will be appointed by the General Assembly for a term of 5 (five) years, with the right to re-election.

7.4 The administrator is the legal representative of the Company and represents the Company in relations with third parties.

7.5 The administrator is responsible for the usual commercial activity of the Company and exercises its powers in accordance with the Articles of Association of the Company and the Company Law.

7.6 In case the Company appoints more than one administrator, the Company may be represented by each of them individually, through a single signature. However, the Company may establish other representation rules for the administrators, which are approved by resolution of the General Assembly, which shall be notified to the administrators and registered with the Commercial Register of the National Business

| TË NDRYSHME | Centre.<br><br>MISCELLANEOUS |
| --- | --- |
| **Neni 8**<br><br>Ky Akt Themelimi është hartuar në gjuhën shqipe dhe angleze. Në rast mospërputhjesh mes të dy gjuhëve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze. | **Article 8**<br><br>The present Act of Incorporation has been drawn up in Albanian and English languages. In case of discrepancies between the two languages, the English language version will prevail. |
| **Neni 9**<br><br>Të gjitha çështjet që nuk parashikohen shprehimisht në këtë Akt Themelimi do të rregullohen nga dispozitat e Statutit dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare, si dhe nga dispozitat e legjislacionit në fuqi. | **Article 9**<br><br>All the matters not expressively foreseen in the present Act of Incorporation shall be governed by the provisions of the Articles of Association and the Company Law, as well as by the provisions of the legislation in force. |

Nënshkruar nga Ortakët e Shoqërisë:/Signed by the Partners of the Company:

**Aga Solar Holdco Limited**
Përfaqësuar nga: / Represented by:
Farai Sekeso

**NOTUS Energy Albania SH.P.K.**
Përfaqësuar nga: / Represented by:
Rico Koch

Notus Energy Albania
Sh.p.k.
NUIS: M32122022B , Tirana

**AGA-SOLAR SH.P.K.**
Përfaqësuar nga: / Represented by:
Arkond Canaj

NUIS: M 11415029 E
AGA SOLAR
Sh.p.k.
TIRANË - ALBANIA